



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 24.16.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMISIONIT TË**  
**PAVARUR TË MEDIAVE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31**  
**DHJETOR 2017**

**Prishtinë, maj 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit të Pavarur të Mediave, në konsultim me Ndihmëse Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Burbuqe Idrizi (Udhëheqëse ekipi) dhe Shpresa Zenelaj (Anëtare e ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Ramadan Gashi.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	9
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	18
5 Qeverisja e mirë.....	18
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	21
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak dhe vitet e mëhershme .....	24
Shtojca III: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit .....	27
Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....	31

## Përmbledhje e përgjithshme

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 11/07/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komisionit të Pavarur të Mediave.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komisionit të Pavarur të Mediave për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


#### **Opinion i pamodifikuar**

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



## Përgjigja e menaxhmentit-2017

Menaxhmentit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me pjesën të të gjeturave të detajuara dhe konkluzionet e auditimit. Komentet për të cilat janë pajtuar pjesërisht apo nuk janë pajtuar mund t'i gjeni në shtojcën III.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komisionit të Pavarur të Mediave. Ne kemi analizuar veprimtarinë e organizatës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryeshefi Ekzekutiv është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi

apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komisionit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KPM-së.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



---

## 2.1 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

KPM-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr.01/2013 dhe nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK) ;
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2017; dhe
- PVF janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

### **DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMISIONIT TË PAVARUR TË MEDIAVE**

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

## 2.2 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

## Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve tjera të kontrollit. Procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) siç parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP). Megjithatë, sfidë për institucionin edhe më tutje mbetet mbulimi i pozitave kyçe me ushtrues detyre përtej afatit të paraparë ligjor, si dhe menaxhimi i pasurisë.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>1,214,276</b>	<b>764,276</b>	<b>728,953</b>	<b>992,514</b>	<b>1,252,430</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,214,276	764,276	728,953	992,514	1,252,430

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte reduktuar për 450,000€. Kjo diferencë është rezultat i reduktimit të buxhetit me vendimit të Qeverisë nr.08/151 të dt. 02.08.2017, në kategorinë e investimeve kapitale për projektin kapital „Ndërtimi i objektit të KPM-së”.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,214,276</b>	<b>764,276</b>	<b>728,953</b>	<b>992,514</b>	<b>1,252,430</b>
Pagat dhe Mëditjet	388,292	388,292	370,499	343,425	362,239
Mallrat dhe Shërbimet	347,984	347,984	331,650	339,752	286,879
Shërbimet komunale	28,000	28,000	26,804	16,693	26,999
Investimet Kapitale	450,000	-	-	292,644	576,313

Në vitin 2017, KPM ka shpenzuar 728,953€ apo 95% të buxhetit final, me një zvogëlim prej 5% krahasuar me vitin 2016. Në përgjithësi, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm.

- Për kategorinë e pagave dhe mëditje nuk kishte ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe atij final. Mjetet financiare të pashpenzuar në fund të vitit ishin 17,793€, kjo si rrjedhojë se katër pozita kishin mbetur të pa plotësuar me staf gjatë viti 2017; dhe

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

- Kategoria e mallrave dhe shërbimeve nuk kishte ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe atij final, por se mjetet financiare të pashpenzuar në fund të vitit ishin 16,334€, kanë rezultuar si rrjedhojë e zvogëlimit të shpenzimeve të internetit.

## 3.2 Të hyrat

KPM realizon të hyra nga shërbimet mediale audio-vizuele nga këto burime, si; tarifa për aplikim të licencës, tarifa vjetore e licencës, tarifa për ndryshim dhe vazhdim të licencës. Në vitin 2017 kishte realizuar edhe të hyra nga dënimet dhe gjobat për media. Të hyrat e realizuara janë transferuar në Buxhetin e Kosovës.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	418,156 <sup>2</sup>	418,156	206,362	282,103	309,326
<b>Totali</b>	<b>418,156</b>	<b>418,156</b>	<b>206,362</b>	<b>282,103</b>	<b>309,326</b>

KPM kishte planifikuar të realizoj të hyra në vlerë prej 418,156€, dhe se prej tyre ishin mbledhur 206,362€ apo 49% e të hyrave të planifikuara. Të hyrat e mbledhura ishin të hyrat nga licenca (192,985€), dënimet (997€) dhe nga gjobat (12,380€) përfshirë edhe pagesat nga vitet paraprake.

Ky nivel i ultë i inkasimit të hyrave ishte rezultat i ndryshimit të rregullores së të hyrave (rregullorja e vjetër<sup>3</sup> ka përcaktuar tarifat më të larta për këto shërbime, ndërsa inkasimi është bërë sipas rregullores së re<sup>4</sup>). Në mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

## 3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive organizative. Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave (punëtorët aktual, rekrutimet, largimet,

<sup>2</sup> Planifikimi i Buxhetit-KPM-ja nuk kishte përgatitur ndonjë plan detal lidhur me arkëtimin e të hyrave dhe nuk i kishte paraparë me ligj të buxhetit, mirëpo vlera e prezantuar ishte paraparë me "planifikimin dhe kërkesa buxhetore 2017-2019 (PCF4)".

<sup>3</sup> KPM-2014\_03 Rregullore e pagesës për licencë.

<sup>4</sup> KPM\_2017\_03 Rregullore për tarifën vjetore për licencë e datës 25.01.2017 (e cila e shfuqizon rregulloren KPM-2014\_03).

---

pushimet e lehonave dhe punëtorët e pensionuar). Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

---

### Çështja 1 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta

**E gjetura** Sipas nenit 12 të Ligjit për Shërbimin Civil nr.03L/149, kohëzgjatja e marrëveshjeve për shërbime të veçanta duhet të jetë për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit, dhe kandidatët potencial i nënshtrohen Ligjit për Detyrime.

Ne identifikuam se KPM-ja në vitin 2017 kishte lidhur marrëveshje për shërbime të veçanta me dy punonjës për pozitat, *Zyrtarë për Koordinim dhe Ndërlidhje* dhe *Zyrtarë për Përpunimin e të Dhënave* në kohëzgjatje mbi gjashtë (6) muaj. Pagesa për këto shërbime ishte bërë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (kodi 13460) në shumën 7,537€. Kontratat për shërbime të veçanta janë lidhur për pozita të zakonshme e jo për ekspertë të fushave përkatëse dhe për të njëjtat nuk është zhvilluar procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Pas rekomandimit tonë, kjo formë e kontraktimit ishte ndërprerë në fund të vitit 2017.

**Rreziku** Marrëveshja për shërbime të veçanta pa procedura të thjeshtësuara të rekrutimit në kohëzgjatje mbi gjashtë (6) muaj dhe për pozitë të zakonshme, kufizon konkurrencën dhe rritë rrezikun që shërbimet të mos jenë reale me nevojat e KPM-së dhe buxheti i planifikuar për këtë kategori të mos shpenzohet sipas qëllimit të caktuar.

**Rekomandimi 1** Kryetari i Komisionit duhet të sigurohen se marrëveshjet për shërbime të veçanta përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, të planifikohen drejtë dhe të bëhen në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi.

## Çështja 2 - Pagesat e pushimit të lehonisë

- E gjetura** Neni 12 i Rregullores 06/2011, përcakton se (6) gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë, nëpunësja paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës bazë. Në një rast të shfrytëzimit të pushimit të lehonisë gjatë vitit 2017, të punësuarës iu kishte kompensuar edhe shtesa e SHCK-së prej 30€ në muaj në periudhën e parë të shfrytëzimit të pushimit të lehonisë.
- KPM kishte kërkuar sqarim nga MAP me datë 20.11.2017 lidhur me formën e kompensimit të lehonave, mirëpo nuk kishte pranuar ndonjë sqarim formal lidhur me këtë çështje.
- Rreziku** Mos ndalesa e shtesës të SHCK-së gjatë pushimit të lehonisë rrezikojnë që me rastin e kompensimit të lehonave të dëmtohet buxheti i KPM-së.
- Rekomandimi 2** Kryetari i Komisionit duhet të sigurojnë se në rastet e shfrytëzimit të pushimit të lehonisë, kompensimet të bëhen në harmoni të plotë me kërkesat ligjore dhe të siguroj vendosjen e kontroleve të shtuara për të parandaluar gabimet e identifikuara në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten.

## 3.4 Menaxhimi i personelit

Numri i aprovuar i stafit për vitin 2017, ishte 41 pozita, ndërsa numri aktual i punësuarave në fund të vitit ishte 37. Katër pozita kanë mbetur pa u plotësuar dhe se kjo ka ndodhur për shkak se një i punësuar është pensionuar, dy pozita kanë qenë të lira (pozita e NJAB dhe pozita e një anëtari të Bordit), dhe një pozitë e anëtarit të komisionit edhe pse është plotësuar në fund vit i punësuar nuk ishte proceduar në listën e pagave.

Përkundër kësaj, shpenzimi i buxhetit për paga dhe mëditje ishte 95%. Kjo ndodhur për shkak të angazhimit të stafit të KPM-së me punë jashtë orari për mbikëqyrjen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës si dhe zgjedhjet e rregullta lokale të vitit 2017. Pagesat për punë jashtë orarit janë realizuar për muajt (korrik/tetor/nëntor dhe dhjetor).

### Çështja 3 - Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre

- E gjetura** Sipas nenit 30 të LShC, në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës (UD) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj.
- Gjatë auditimit vërejtur se një nga katër pozitat që mbulohen me ushtrues detyre (UD) kishte tejkaluar afatin e lejuar për mbajtjen e pozitës UD. Pozita e Zyrtarit të Lartë për Marrëdhënie Publike mbulohet me U.D nga data 01.06.2017, përveç kësaj i njëjti person e kishte ushtruar këtë detyrë (prill/dhjetor 2016). Kjo praktikë mbetet edhe më tutje sfidë për plotësimin me staf të rregullt të pozitave që mbulohen me UD.
- Rreziku** Praktika e mbulimit të pozitave me UD për periudha të gjata kohore përveç se nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme në mungesë të konkurrencës së hapur. Kjo mund të ndikojë negativisht në performancën e organizatës në përgjithësi.
- Rekomandimi 3** Kryetari i Komisionit duhet të sigurohen zhvillimin e procedurave të rekrutimit që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta. Kohëzgjatja e funksionit si U.D të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.

### 3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzime komunale ishte 375,984€. Prej tyre ishin shpenzimet 358,454€ apo 95%. Pjesa më e madhe e shpenzimeve përfshijnë shpenzimet e qeras, të mirëmbajtjes dhe riparimeve, të udhëtimit dhe shpenzimet kontraktuese tjera. Për shpenzimet e reprezentacionit KPM-ja nuk ka një rregullim të brendshëm, ku përcaktohet mënyra/niveli i shpenzimeve dhe personeli kyç që ka të drejtën e shfrytëzimit të reprezentacionit. Përveç kësaj testimet tona kanë venë në pah mangësitë si në vijim.

#### Çështja 4 – Pagesë për shërbime të trajnimit

- E gjetura** KPM me datë 21.02.2017, kishte bërë një pagesë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (13410) për programin e zhvillimit profesional “MASTERCLASS” në llogarinë Albany Associates LTD në vlerë 20,740€. Trajnimi “Rregullat dhe procedurat për transmetim digjital” ishte organizuar me datë 28.02-02.03.2017 nga Albany Associates LTD në Tiranë për 17 zyrtarët e KPM-së. Pagesa si paradhënie ishte ekzekutuar duke u bazuar vetëm në një çmimore, agjendë të dërguar me e-mail (dt. 23.01.2017) dhe faturës së datës 20.02.2017, pa ndonjë marrëveshje/ kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve. KPM-ja kishte arsyetuar mjetet e dhëna për këtë trajnim me listat e pjesëmarrësve të zyrtarëve duke siguruar zbatimin e projektit trajnues. Pagesa e më sipërme nuk është në pajtim me Ligjin e buxhetit nr. 05/L-125 neni 14 dhe nenit 26<sup>5</sup> të rregullores nr.01/2013.
- Rreziku** Ekzekutimi i pagesës nga KPM para konfirmimit se shërbimet e trajnimit janë mbajtur për zyrtarët e tij rrit rrezikun që objektivat të arrihen pjesërisht apo edhe të mos arrihen fare nga palët, dhe të ketë vlerë të dobët për parane e dhënë. Kjo formë e pagesës mund të konsiderohet si e parregullt dhe mund t’i shkaktojë dëme financiare KPM-së.
- Rekomandimi 4** Kryetari i Komisionit duhet të sigurohen se nuk do të realizojnë pagesa para se të konfirmohet se shërbimet e trajnimit janë kryer. Pagesave nga mallrat dhe shërbimet duhet ti paraprin një marrëveshje ku përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve dhe të jenë në pajtim me ligjin e buxhetit dhe rregulloret në fuqi.

### 3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores së MF nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PFV 2017 ishte në vlerë 698,828€, pasuria jokapitale nën 1,000€ ishte në vlerë 25,449€, ndërsa stoqet ishin 409€. Më tutje, 73% të pasurive kapitale të regjistruara në regjistrin kontabël në SIMFK dhe 67% të pasurive jo kapitale të regjistruara në regjistrin e-pasuria janë me vlerë zero. Përveç kësaj, stoqet dhe materiali shpenzues në KPM nuk ishte i vendosur në hapësira të përshtatshme (depo), kjo si pasoj e mungesës së hapësirave të objektit.

Auditimi ynë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi dobësitë e paraqitura më poshtë.

<sup>5</sup> Asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozita e LMFPP.



## Çështja 5 – Menaxhimi i pasurive

**E gjetura** KPM me dt. 03.01.2018 kishte themeluar komisionin për inventarizimin e pasurive, mirëpo komisioni nuk kishte arritur ta përmbyll procesin dhe të nxjerrë një raport mbi ekzistencën dhe gjendjen e pasurive deri me 29.01.2018. Si rrjedhojë, rezultatet e inventarizimit nuk ishin reflektuar në PVF. Po ashtu, KPM nuk kishte formuar komisionin e vlerësimit të pasurisë financiare, siç e kërkon Rregullorja për menaxhimin e pasurisë nr. 02/2013.

KPM nuk e aplikon sistemin e-pasuria për regjistrim të stoqeve<sup>6</sup>, kështu që, vlera prej 409€ e stoqeve e prezantuar në pasqyra ishte bazuar vetëm në numërimin fizik të tyre.

**Rreziku** Mungesa e komisionit për vlerësim të pasurive, mos aplikimi i sistemit e-pasuria për stoqe dhe vonesa e inventarizimit të pasurive në fund të vitit, rritë rrezikun që në regjistrat e pasurisë të mbahen evidenca të pa sakta dhe shpalsje jo e drejtë në PVF. Në kushte të tilla, pasuria i ekspozohet rrezikut për humbje, keqpërdorim apo tjetërsim.

**Rekomandimi 5** Kryetari i Komisionit duhet të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionin për vlerësim të pasurive në mënyrë që të bëjnë vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjitha pasurive si dhe të konfirmojnë shkallën e tyre funksionale/të përdorimit. Rezultatet e raporteve përfundimtare duhet të shqyrtohen nga KPM dhe të pasohen me regjistrimet e nevojshme kontabël përputhje me kërkesat rregullative.

## 3.7 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paraja e gatshme ishte menaxhuar në harmoni me rregullën 01/2013 për shpenzimin e parave publike shpenzimeve. Të gjitha transaksionet e parave të imëta ishin regjistruar në llogarinë përkatëse me rastin e arsytimit të shpenzimeve të bëra nga fondi i parave të imëta.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

## 3.8 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme (LL/A) e paraqitur në PFV ishte në vlerë 545,239€. Krahasuar me vitin paraparak (290,371€) ato kishin shënuar rritje për 254,868€.

<sup>6</sup> Nenin 6 paragrafi 3 dhe nenin 24 paragrafin 2 të rregullores 02/2013



---

KPM nuk ka arritur t'i arkëtoj të gjitha LLA për të cilat ka ofruar shërbime për operatorët e licencuar. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga tarifatat vjetore e licencimit për të gjitha kategoritë e të licencuarve, dënimet dhe gjobat e viteve paraprake.

LL/A të vitit 2011 dhe 2013 ishin proceduar për inkasim në Gjykatën Themelore, ndërsa llogaritë e arkëtueshme të viteve (2014/2015/2016 dhe 2017) ishin proceduar për inkasim të përmbaruesit privat.

Përkundër që KPM kishte ndërmarr masa konkrete për mbledhjen e të hyrave, si njoftimi me kohë për operatorët e shfrytëzimit të licencave dhe dërgimi i lëndëve në gjykatë dhe te përmbaruesi privat, prapë ka rezultuar me nivel të larta të LL/A.

Rritja e LL/A në raport me vitin e kaluar ishte për shkak se KPM, lëndët të cilat i kishte dërguar për inkasim në Gjykatë dhe të përmbaruesi privat i kishte trajtuar si pasuri kontingjente në PVF. Kjo nuk ishte në pajtim me SNKSP 19 -paragrafin 40 si dhe me rregulloren nr.02/2013 neni 14 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. PVF janë përmirësuar nga KPM dhe vlera e pasurive kontingjente (371,822€) është shpalosur në LL/A.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### **3.9 Obligimet e papaguara**

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 27,002€, të cilat janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Arsyeja e mos pagesës ishte mungesa e mjeteve si dhe faturat e pranuar në vitin 2018.

KPM ka një sistem të mirë kontrolli për menaxhimin e pagesave dhe raportimi i obligimeve ishte bërë në baza të rregullta mujore në thesar.

Përgjatë kësaj, raporti i obligimeve të papaguara përmbante 20 fatura në vlerë prej 21,032€, prej të cilave (1,877€) komunalitë të cilat i kishte pranuar në janar 2018. Kjo shpalosje nuk ishte në përputhje me Rregulloren nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar - Neni 17 e cila përcakton se organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV të vitit 2016 të KPM-së, ka rezultuar me gjashtë rekomandime. KPM kishte përgatitur Planin e Veprimit brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për vitin 2016 të ZKA, ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, katër rekomandime janë zbatuar, një rekomandim ishte në proces, dhe një rekomandim nuk ishte adresuar ende. Rekomandimi në proces ka të bëjë me strategjinë të cilën e kishte hartuar KPM por nuk ishte aprovuar nga Qeveria, kurse rekomandimi i pa adresuar ka të bëjë me çështjen e mbulimit të pozitive me UD.

Për më tepër, nga viti 2015, nga pesë rekomandimet e dhëna katër rekomandime ishin zbatuar në vitin 2017 dhe një rekomandim ishte në proces<sup>7</sup>. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë përfshinë parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerri veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërme.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

KPM në përgjithësi ka kontrolle të duhura në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të kontrollit. Qeverisja në KPM në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, pasqyron një situatë pozitive. KPM ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve, kishte identifikuar disa rreziqe që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Pyetësi i

<sup>7</sup> Hartimi i Strategjisë nga KPM, mirëpo nuk ishte aprovuar nga Qeveria e Kosovës.

vet-vlerësimit i plotësuar nga KPM e pasqyron gjendjen aktuale. Mungesa e strategjisë gjithëpërfshirëse është dobësi e mjedisit të kontrollit dhe numri i vogël i stafit paraqet sfidë për KPM në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive.

## 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Në bazë të UA. nr.23/2009 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, KPM nuk i plotëson kriteret<sup>8</sup> për themelimin e NjAB-së. Në mungesë të NjAB-së, auditimi i brendshëm kryhet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB) në kuadër të Ministrisë së Financave (MF).

Gjatë vitit 2017, nuk ishte zhvilluar ndonjë proces i auditimit të brendshëm nga DAB. KPM në dhjetor të këtij viti, kishte bërë kërkesë në Njësinë Qendrore Harmonizuese që për vitin 2018 të sigurojë Auditor të Brendshëm deri në plotësimin e pozitës apo kryerjen e auditimit.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalesje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

---

<sup>8</sup> Mbi 1 milion buxhet, 50 të punësuar dhe shkalla e rrezikshmërisë së lartë.

---

## Çështja 6 - Mos aprovimi i planit strategjik

- E gjetura** Ndonëse KPM ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se ekzistojnë disa mangësi të cilat pa mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.
- KPM kishte hartuar strategjinë për transmetim digjital në Republikën e Kosovës dhe kishte dërguar për aprovim në Qeveri, mirëpo e njëjta nuk ishte aprovuar për shkak të kostos së lartë. Objektivat strategjike për vitin 2017 i kishte paraparë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019; dhe
  - Në bazë të këtyre objektivave KPM ka hartuar një regjistër për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve të cilat do të rrezikonin arritjen e objektivave, po ashtu menaxhimin e këtyre rreziqeve i kishte përmbledhur në raportet për menaxhimin e tyre, siç e kërkohet me procedurat nr.4 e MFK-së. Raportet ishin bërë në baza të rregullta (ashtu siç rekomandohet në baza tre mujore). Mirëpo, raportet nuk përmbanin rreziqe lidhur me mungesën e stafit dhe mungesën e objektit, dy çështje me të cilat ishte përballur KPM gjatë vitit 2017.
- Rreziku** Mos aprovimi i planit strategjik, pamundëson identifikimin e çështjeve të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e efikasitetit dhe monitorimin e progresit drejt arritjes së rezultateve të dëshiruara.
- Rekomandimi 6** Kryetari i Komisionit duhet të sigurohen aprovimin e strategjisë për transmetim digjital në Republikën e Kosovës dhe analizim më të detajuar të rreziqeve me të cilat përballlet KPM.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit	Kryetari i komisionit duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		KPM kishte hartuar strategjinë për transmetim digjital në Republikën e Kosovës dhe kishte dërguar për aprovim në Qeveri, mirëpo e njëjta nuk ishte aprovuar për shkak të kostos së lartë.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat financiare – Theksimi i çështjes për faktin se pasuria jokapitale në vlerë prej 26,027€ nuk është shpalosur në Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se janë marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, duhet të forcohen kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, përfshirë edhe raportimin e tyre në PVF.	Po, ky rekomandim është zbatuar.		



2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit	Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se është analizuar plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të procesit të menaxhimit të rrezikut në mënyrë që të parandalohen rreziqet të cilat pengojnë arritjen e objektivave të organizatës.		KPM kishte hartuar strategjinë për transmetim digjital në Republikën e Kosovës dhe kishte dërguar për aprovim në Qeveri, mirëpo e njëjta nuk ishte aprovuar për shkak të kostos së lartë.	
3.1.1 Të hyrat - Vonesat në arkëtimin e të hyrave	Kryetari i komisionit të KPM-së duhet të shtoj kontrollet për arkëtimin me kohë të të hyrave në bazë të planifikimit vjetor dhe legjislacionit, si dhe të filloj të ekzekutoj sanksionet në rast të mos pagesës me kohë të tarifave.	Po, ky rekomandim është zbatuar.		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet - Mbulimi i Pozitave me Ushtrues Detyre	Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të ndërmer veprime për të ndërprerë praktikën e mbulimit të pozitave me U.D, si dhe të iniciohen procedurat e rekrutimit në mënyrë që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta sipas përcaktimit ligjor.			Jo, ky rekomandim nuk ishte zbatuar sepse fenomeni i mbulimit të pozitave me UD me gjatë se sa është e lejuar me ligj ishte prezent edhe në vitin 2017.

3.1.3 Blerja dhe procedimi nga kategoria jo-adekuatë	Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet siguruar që shpenzimet buxhetohen drejtë sipas kategorive ekonomike, si dhe blerjet/pagesat kryhen dhe evidentohen në kategoria adekuatë me qëllim të shpalosjes së drejtë të shpenzimeve në PFV.	Po, ky rekomandim është zbatuar.		
3.3 Mos raportim i obligimeve në listën e obligimeve	Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se raportimi i obligimeve të papaguara do të bëhet në përputhje me rregulloren 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara. Vlerat e sakta të obligimeve duhet të përcillen nga një muaj në tjetrin, në përputhje me kërkesat ligjore.	Po, ky rekomandim është zbatuar.		

### Shtojca III: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e OB-së në rast të mospajtitimit.	Pikëpamjet e ZKA-së.
Çështja 2: Pagesat e Pushimit të lehonisë.	Jo	KPM ka kërkuar sqarim nga MAP me datë 20.11.2017 lidhur me formën e kompensimit të lehonave, mirëpo nuk ka pranuar ndonjë sqarim formal lidhur me këtë çështje. Meqenëse pagat llogariten nëpërmjet sistemit të payroll-it në kuadër të MAP-it, logjikisht KPM nuk ka qasje për ndërhyrje të ndalesës së shtesës të SHCK-së.  Sipas KPM-së kishte qenë e drejtë që MAP-i të merret lidhur me kompensimet e lehonave.	Në brendi të komentit të KPM-së nuk mohohet e gjetura por vetëm jepen shpjegime të cilat i kemi prezantuar në raport. Për këtë çështje nuk është ofruar asnjë dëshmi që e vërteton të kundërtën, prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.
Çështja 3: Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre	Pjesërisht	Caktimi i Ushtruesit të Detyrës për pozitën e Zyrtarit të Lartë për Marrëdhënie me Publikun nga data 1 qershor 2017 deri më 28 shkurt 2018 kur Zyrtarja e Lartë për Marrëdhënie me Publikun është transferuar në pozitën e Zyrtares së Lartë për Monitorim Regjional në Departamentin për Monitorim dhe Analizë. Ka qenë domosdoshmëri që të caktohet dikush nga stafi për të siguruar që nuk ndërpritet komunikimi me media dhe me institucionet tjera dhe që faqja zyrtare e KPM-së menaxhohet nga stafi i brendshëm për të evituar çfarëdo problemi. Komunikimi me media është një ndër elementet më të rëndësishme në kryerjen e misionit të KPM-së së bashku edhe me korrektësinë që duhet treguar në dhënien e përgjigjeve kundrejt kërkesave që vijnë nga publiku dhe të tjerë, dhe në pritje të aprovimit të pozitave të lira të punës nga MAP, kemi qenë të detyruar që këto detyra të mbulohej duke caktuar U.D. bazuar në Nenin 30 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.	KPM vetëm e ka arsyetuar mbulimin e pozitës me UD. Mirëpo për këtë çështje nuk është ofruar asnjë dëshmi që e vërteton të kundërtën, prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.

<p>Çështja 4: Pagesë për shërbimet e trajnimit.</p>	<p>Jo</p>	<p>Në këtë rekomandim thuhet se pagesa për këtë trajnim nuk është në pajtim me ligjin e buxhetit nr. 05/L-25 i nenit 14 dhe neni 26 të rregullores nr. 01/2013. Sa për sqarim në nenin 14 pika 1 i referohet pagesave që kryhen përmes procedurave të prokurimit për mallra dhe shërbime dhe projekte kapitale dhe nuk i specifikon me theks të veçantë trajnimet e stafit. Ashtu siç është paraparë ligjin e prokurimit trajnimet janë të përjashtuara, konkretisht sqarohet në Nenin 3 përjashtimet, pika 6 e ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 thotë se: <i>Ky ligj nuk do të zbatohet për një kontratë të punësimit, nëse aktiviteti i tillë i prokurimit është lëndë e rregullave të tjera që vendosen me një ligj ose rregullore tjetër. Njëjtë, ligji aktual nuk do të aplikohet për kontratat në lidhje me trajnimet pasuniversitare apo trajnime profesionale nga punëdhënësit për zhvillimin e aftësive specifike të punëtorëve individualë. Për më shumë, ligji nuk do të aplikohet në prokurim ekskluzivisht të orientuar në përfaqësimin në formë të ofrimit të ushqimit dhe pijeve.</i></p> <p>Ndërsa edhe tek neni 26 i rregullores nr. 01/2013 konkretisht në pikën 2 specifikohen rastet që duhet përmbushur për tu kryer një pagesë ku parashihet kopjen e kontratës se nënshkruar nga zyrtari i prokurimit e që në këtë rast prapë i referohet procedurave të prokurimit që në rastin tonë ashtu siç u cek edhe më lart nuk është vepruar në bazë të ligjit të prokurimit pasi që në nenin 3 këtij ligji trajnimet janë përjashtuar.</p> <p>Sa i përket pagesës në avanc për trajnimin e paraparë është praktikë në të gjitha institucionet që duhet të bëhet fillimisht pagesa për tu bërë rezervimi i trajnimit, pagesat për rezervimet në konferenca ndërkombëtare etj, sidomos në rastet ku këto trajnime ofrohen nga kompani ndërkombëtare apo me te autorizuar të tyre. Po ashtu meqë trajnimet janë të përjashtuara nga prokurimi dhe avanset në përqindje ashtu siç janë të paraqitura më lartë bëhet</p>	<p>Neni 14 i ligjit të buxhetit (05/L-25) e përcakton rastet që mund të lejohet pagesa paradhënie ("Organizatave buxhetore mund të paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në (15%) të vlerës së kontratës. Pagesa e tillë e paradhënies mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur në mënyrë ligjore, me vlerë më të lartë se dhjetë mijë (10.000) Euro, e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik").</p> <p>Prandaj, neni 3 pika 6 e Ligjit të Prokurimit Publik shpenzimet e trajnimeve i përjashton nga ky ligj, atëherë pagesat si paradhënie për këto shërbime nuk lejohen në bazë të ligjit të buxhetit (neni 14).</p> <p>Nenin 26 pika 1 e rregullores për shpenzimin e parave publike 01/2013 (i sqaruar edhe në raport me fusnote tek çështja 4) thuhet "Asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozita e LMFPF. Për me tepër nuk kishte fare marrëveshje/ kontratë lidhje</p>
---	-----------	--	---

		<p>fjalë vetëm për projekte kapitale si dhe kontrata të nënshkruara përmes procedurave të prokurimit në këtë rast e vetmja rregullore që rregullon avancet dhe i lejon avancet, si ne rastin tonë pa procedura të prokurimit është rregullorja nr. 01/2013 konkretisht te neni 21, paragrafi 2, pika 2.3.</p> <p>2.3. <i>Avancat për udhëtime.</i></p>	<p>me shërbimin për trajnime.</p> <p>Mirëpo për këtë çështje nuk është ofruar asnjë dëshmi që e vërteton të kundërtën, prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.</p>
<p>Çështja 5: Menaxhimi i pasurive</p>	<p>Jo</p>	<p>KPM-ja ka bërë menaxhimin e pasurive siç e parasheh : Rregullorja për menaxhimin e pasurisë nr. 02/2013. Neni 6 si dhe rregullat e Thesarit.</p> <p>KPM-ja ka themeluar komisionin për inventarizim e pasurive dhe stoqeve, ku komisioni ka dal me raport lidhur me inventarizimin e pasurive dhe stoqeve siq e parasheh rregullorja për menaxhimin e pasurive nr 02/2013 Neni 19 pika 1,2,3,4,5,6 ku ky raport po ashtu ka reflektuar në Pasqyrat financiar vjetore për vitin 2017.</p> <p>Sa i përket themelimit të komisionit për vlerësimin e pasurive, KPM-ja nuk ka pasuri që janë jashtë përdorimit, në pritje të tjetërsimit (kërkesa për tjetërsim) si dhe pasuri të dëmtuara që është dashur të vlerësohen etj.</p> <p>Ashtu siç e parasheh rregullorja për menaxhimin e pasurisë Nr.02/2013 Neni 21 pika 4, Përgjegjësitë e Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë jo Financiare janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>4.1. Vlerësimi i pasurive të dëmtuara;</li> <li>4.2. Vlerësimi i kërkesave për tjetërsim të pasurive;</li> <li>4.3. Prezantimi i dëshmimeve për vlerësimin e pasurisë;</li> <li>4.4. Përgatitja e raportit për pasurinë jo financiare që duhet të largohet nga përdorimi.</li> </ol> <p>KPM në mungesë të stafit si dhe për nga përbërja e një numri të</p>	<p>Komisioni i inventarizimit e kishte përfunduar punën me 29.01.2018. Në këtë raport ishin identifikuar 3<sup>9</sup> raste të aseteve që janë jashtë përdorimi/të prishura dhe për të njëjtat nuk ishte formuar komisioni për vlerësimin e atyre aseteve. Po ashtu nuk janë ofruar dëshmi te cilat vërtetojnë se ka reflektuar në Pasqyra.</p> <p>Në pjesën tjetër të komentit të KPM-së nuk mohohet e gjetura por vetëm jepen shpjegime të njohura për ne, të tilla i kemi prezantuar në raport. Mirëpo për këtë çështje nuk është ofruar asnjë dëshmi që e vërteton të kundërtën, prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.</p>

<sup>9</sup> Pasuria me barkod KPrKPM1-199 , pasuria me barkod KPrKPM1-200, pasuria me barkod KPrKPM1-799 te konstatuara nga komisioni I inventarizimit jashtë përdorimit gjenden ende në raportin pasuria sipas vlerës.

		vogël të stafit, nuk ka aplikuar sistemin E-pasuria për regjistrim të stoqeve. Vlera prej 409 euro e stoqeve e prezantuar në pasqyra është e bazuar në numërimin fizikë të tyre nga ana e Komisionit për Inventarizimin e pasurive dhe stoqeve. Janë marr masat për vitet në vijim të aplikohet sistemi E-pasuria për stoqe.	
Çështja 6: Mos aprovimi i planit strategjikë	Pjesërisht	<p>Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, Neni 3, pika 1.1, KPM është e ngarkuar me mandatin për të hartuar Strategjinë për kalim në transmetim digjital në Republikën e Kosovës si dhe dokumentet tjera strategjike për shërbimet mediale audiovisual.</p> <p>Strategjia për digjitalizim definon në mënyrë gjithëpërfshirëse procesin e kalimit të transmetimit televiziv tokësor analog në transmetim tokësor digjital. Kjo strategji definon në mënyrë të qartë orientimet strategjike zhvillimore, obligimet dhe afatet kohore të kalimit të transmetimit tokësor analog në atë digjital, në pajtim të plotë me standardet e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU-së) dhe të Komisionit Evropian.</p> <p>Strategjia për kalim në transmetim digjital në Republikën e Kosovës është përgatitur nga KPM-ja dhe miratohet nga Qeveria, ashtu siç e parasheh Ligji për KPM-në.</p> <p>Kjo Strategji krijon kosto shtesë buxhetore për periudhën e implementimit të saj dhe kjo kosto nuk është pjesë e ndarjes buxhetore për vitin fiskal 2018 e as në projeksionet buxhetore për vitet 2019-2022.</p> <p>Strategjia është dërguar në Qeveri, mirëpo nuk është aprovuar për shkak të lartësisë së kostos.</p> <p>KPM e mirëpret nga Qeveria përkrahjen dhe miratimin e Strategjisë për kalim në transmetim digjital në Republikën e Kosovës.</p>	<p>KPM vetëm e ka arsyetuar çështjen e mos-aprovimit të strategjisë gjë që edhe ne e kemi prezantuar në raport.</p> <p>Prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.</p>

## Shtojca IV: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: 24.04.2018

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Raportit Financiar të Komisionit të Pavarur të Mediave për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet; kemi dhënë disa komente dhe sqarime shtesë për konsideratën tuaj si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Naile KRASNQI

Kryeshefe Ekzekutive

